ROXANNA PANUFNIK KOMPOZITORE VJESHTË NË SHQIPËRI

Përgatitur nga Mal Berisha

Roxanna Panufnik është kompozitorja britanike e cila ka arritur kulmin e saj të suksesit me veprën muzikore "Katër stinët e botës". Ajo vepër ishte zgjedhur si Premjerë për nder të Olimpiadës Botërore London 2012 dhe është luajtur nga orkestra London Mozart Players. Soliste ishte violinistja shumë e famshme britanike Tasmin Little, në kohën e tretë me titull:

VJESHTË NË SHQIPËRI

Premiera botërore e kësaj vepre muzikore u përzgjodh nga BBC Radio 3 në transmetim të drejtpërdrejtë. Në tërësi, vepra muzikore e kompozitores Panufnik ka si qëllim ndërtimin e urave muzikore midis besimeve të ndryshme monoteiste. Aty përfshihen këngët e krishtera, islame dhe hebraike për të krijuar një analogji muzikore për faktin se këto tre fe besojnë në një Zot.

Vepra VJESHTË NË SHQIPËRI është një pjesë muzikore e cila pasqyron shpirtin e popullit shqiptar në tallazet e tij të jetës, me uljet dhe ngritjet e veta historike dhe emocionale. Ajo është e bazuar tërësisht mbi një melodi të muzikës popullore shqiptare.

Ajo përvecse në Londër është luajtur, në praninë e autores edhe nga Orkestra Simfonike e Radio Televizionit Shqiptar në vjeshtën e vitit 2013.

Kompozitorja Panufnik, është një mike e popullit shqiptar e sidmos e artistëve shqiptaro – britanik në Londër, **Mariela Cingo**, **Tomorr Kokona Arts-Management**, **Alda Dizdari**, etj.

Proud to be Albanian!